VENDIM
Nr. 172, datë 3.3.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 835, DATË 18.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1, e kreut III, të vendimit nr. 825, datë 18.9.2013 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Hartimi dhe zbatimi i strategjive e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet bashkëpunimit ekonomik, për të gjitha institucionet qendrore në vend.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama